



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDIM

NR. 20, DATË 21 / 11 /2024

PËR MOSPRANIM TË KËRKESËS PËR PËRFITIM TË STATUSIT
“INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E VEÇANTË” PËR
PROJEKTIN E INVESTIMIT “TEDA ALIEN HOUSE” ME SUBJEKT APLIKUES
ALIEN HOUSE SH.A NUIS M32106030E

Në mbështetje të Nenit 9, nenit 13 dhe nenit 17 pika 5 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, Kreu I, pika 3/d të VKM-së Nr. 1023, datë 16.12.2015 “Për Nënsektorët Strategjikë dhe Zonat me Përparësi Zhvillimi” dhe Kreut II, pika 8, 10 e VKM-së Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Komiteti i Investimeve Strategjike, me propozim të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA),

VLERËSOI:

- Projekti propozohet të realizohet nga subjekti Alien House sh.a NUIS M32106030E.
- Projekti synon zhvillimin Zonës Teknologjike dhe e Zhvillimit Ekonomik (TEDA) Alien House, në Bashkinë Tiranë, në të cilën do të ofrohen shërbime magazinimi dhe shërbime logjistike nëpërmjet përdorimit të sistemeve të sofistikuara robotike të teknologjisë së lartë.
- Projekti i propozuar shtrihet në një sipërfaqe totale prej afërsisht 5,3 ha në pronësi “private” të subjektit propozues.
- Vlera e investimit të projektit me potencial strategjik “TEDA Alien House” plotëson kriteret e parashikuara nga legjislacioni për investimet strategjike dhe parashikohet të jetë 87,200,000 (tetëdhjetë e shtatë million e dyqind mijë) euro, duke punësuar rreth

190 (njëqind e nëntëdhjetë) punonjës.

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDOSI:

1. Mospranimin e kërkesës për përfshirjen e projektit investues “TEDA Alien House”, me subjekt investues Alien House sh.a NUIS M32106030E, Bashkia Tiranë në procedurën e veçantë dhe mbështetjen që ofron ky status.
2. Gjurma e projektit të paraqitur preket nga projekt - studimi “Zgjerimi i autostradës Tiranë - Durrës”. Kjo gjurmë ndodhet midis akseve rrugore A - Autostradë dhe C - Rruge Interurbane Dytësorë, për të cilin zbatohen distancat referuar kuadrin ligjor, ku brezat e rezervuar të akseve rrugore, përcaktohen në Ligjin nr.8378, datë 22.07.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
3. Projekti i propozuar është në mospërputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë.
4. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike dhe i njoftohet investitorit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.
- 5.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTËR

EDI RAMA

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
BLENDI GONXHJA

MINISTËR I FINANCAVE
PETRIT MALAJ

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
MIRELA KUMBARO

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
ANILA DENAJ

AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT
ODISE MOÇKA

SEKRETARIATI TEKNIK I KIS

LAURA PLAKU (SARO)